



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 81/1 Prot.

Tiranë, më 31.03.2021

URDHËR

Nr. 32, Datë 31.03.2021

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË RISHIKUAR TË
AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Në zbatim të Ligjit nr. 72/2012, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe VKM-së nr. 147, datë 20.02.2013, “Për miratimin e rregullores “Për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës, të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor sipas Urdhërit nr. 187, datë 18.12.2020, “Për Miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Programi i Transparencës së ASIG, ka përmbajtje sipas dokumentit bashkëlidhur dhe publikohet në faqen zyrtare, www.asig.gov.al, në menunë “Programi i Transparencës”.
3. Ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe koordinatori për të drejtën e informimit për të bashkërenduar punën për të publikuar apo përditësuar ,sa herë që është e nevojshme, dokumente apo materiale në funksion të programit të transparencës të rishikuar.
4. Programi i Transparencës së ASIG, i miratuar me Urdhërin nr. 18, datë 07.02.2018, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Lorenc Gala

Konceptoi: O. Mato, P/ Sektori



PROGRAMI I TRANSPARENCËS

AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Miratohet:

31.03.2021

Lorenc Çala

Drejtor i Përgjithshëm



PROGRAMI I TRANSPARENCËS SË ASIG

1. Hyrje

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”), dhe në Urdhrin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nr.187, datë 18.12.2020, "Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar" Autoriteti Publik, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, (në vijim “ASIG”) publikon Programin e Transparencës (në vijim “PT”) të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Institucionit.

ASIG publikon informacion sipas veprimtarisë së tij funksionale, si dhe do të rishikojë e përditësojë PT në çdo rast të ndryshimit të aktivitetit institucional, kuadrit ligjor rregullator apo çdo elementi tjetër që ka lidhje me transparencën proaktive.

Në PT, të ASIG, janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë: i plotë, i saktë, i përditësuar, i thjeshtë në konsultim, i kuptueshëm, lehtësisht i aksesueshëm dhe i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të ASIG. Gjithashtu, përpara publikimit të informacionit ASIG vlerëson nëse ka ndonjë kufizim ligjor për publikim.

Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga titullari i ASIG.

Në PT janë të specifikuar kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej të cilave lind detyrimi për publikim. Në publikimin e informacionit, ASIG mban parasysh interesin e publikut, për të mundësuar aksesimin lehtësisht në informacionin publik.

2. Rreth autoritetit

- Struktura organizative e ASIG /Organigrama
- Struktura e pagave
- Funkcionet dhe detyrat e ASIG
- CV-të e nëpunësve që janë subjekt deklarimi sipas ligjit, stafi i ASIG, detyrat e drejtorive.
 - Procedurat që ndjekin funksionarët e lartë të ASIG për të marrë vendime
 - Procedurat dhe mekanizmat për të bërë kërkesë dhe ankesë që lidhen me veprimet ose mosveprimet e ASIG (Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave - Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

3. Kuadri ligjor rregullator

- Legjislacion ndërkombëtar
- Legjislacion kombëtar
- Akte nënligjore

- Rregullore
- Kodi i sjelljes
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit

- Strategji
- Raport vjetor
- Manuale/dokumente politikash, që kanë lidhje me funksionet e ASIG dhe që prek publikun

4. E Drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar

- Koordinator/Emri mbiemri
- E-mail
- Tel
- Adresa
- Orari
- Format kërkesë / Shpjeguese (Hapat që duhet të ndiqen për të bërë një kërkesë për informim)
- Format ankese / Shpjeguese (Procedura e ankimit tek Komisioneri)

5. Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi ASIG

- Dokumente strategjike të punës
- Raporte monitorimi/auditimi
- Dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së ASIG

6. Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të ASIG

- Buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara
- Raport vjetor për zbatimin e buxhetit dhe anekset
- Donacione, sponsorizime
- Dokumente që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara

7. Informacion mbi procedurat e prokurimit të ASIG

- Lista e kontratave të lidhura (përfshirë shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve)
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik
- Regjistri i realizimeve të prokurimit publik
- Informacion mbi zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme

8. Shërbimet që ofrohen nga ASIG

Lista e Shërbimeve* që ofron ASIG, përfshirë afatin kohor dhe tarifat

- Formular aplikimi
- Procedurë ankimimi
- Standardet për cilësinë e shërbimit

9. Njoftimi dhe konsultimi publik

- Njoftimi dhe konsultimi publik (<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/305>)
- Komente/Rekomandime/Opinione të palëve të interesuara/grupe interesi
- Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve
- Raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes
- Procedura/mekanizma për të dhënë mendime lidhur me hartimin e politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AP
- Emër mbiemër të koordinatorit për konsultimin publik, adresë postare/elektronike

Shënim: ASIG nuk ka iniciativë për propozimin e akteve ligjore

10. Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve

- Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes
- Formën e dokumenteve/informacioneve (elektronik, kopje fizike, audio, video, foto)

11. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve i përditësuar (sipas Modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me urdhrin nr.188, datë 18.12.2020)

12. Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga ASIG

- Ndihma shoqërore/subvencioneve të dhëna nga ASIG
- Kategoritë dhe format e ndihmës shoqërore/subvencioneve
- Procedura për të përfituar ndihmën shoqërore/subvencionet dhe dokumentacioni përkatës për aplikim
- Procedura e ankimimit
- Kërkesat dhe përgjigjet

Shënim: ASIG nuk ofron ndihmë shoqërore apo subvencione

13. Informacione/dokumente që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga ASIG

- Njoftime të ndryshme
- Njoftime për procedurat e rekrutimit/pranimit në shërbim civil
- Raporte
- Publikime
- Statistika
- Projekte
- Bashkëpunime.